



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage / Ministry for the Kosova Security Force

Departamenti i Personelit/ Odsek Za Personal/Department For Personnel

Në mbështetje të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr.03/L-045 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-46 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, neni 9, pika 9.1, Rregulloren Nr.02/2013 për Rekrutimin në FSK, neni 12 i kësaj Rregulloreje, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës shpall:

K O N K U R S

Për rekrutimin e pjesëtarëve të rinj të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Grada;	Ushtar/OR-1
Mbikëqyrësi;	Komandanti/Udhëheqësi i Njesisë
Kohëzgjatja e kontratës;	12 vite
Statusi;	Aktiv
Vendi;	FSK

Ministria e Forcave të Sigurisë së Kosovës (MFSK) ushtron mbikëqyrje civile dhe kontroll demokratik mbi FSK-në dhe udhëhiqet nga Ministri i FSK-së, i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Ministria është përgjegjëse për zbatimin e politikave qeveritare për sa iu përket çështjeve që ndërlidhen me FSK-në dhe po ashtu do të veprojë edhe si shtabi i nivelit më të lartë të FSK-së.

Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë krejtësisht vullnetare e ndërtuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Misioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës, si instrument i sigurisë është që ta mbështesë Qeverinë e Republikës së Kosovës. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë janë; Të marrë pjesë në operacionet për reagim ndaj krizave, përfshirë operacionet në mbështetje të paqës. Kjo do të përfshijë operacionet jasht territorit të Republikës së Kosovës, ku do të ftohet për këtë qëllim; të ndihmojë autoritetet civile në përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore, fatkeqësive dhe emergjencave tjera, madje edhe si pjesë e një përpjekjeje reaguese regjionale apo ndërkombëtare; të kryej shkatërrimin e mjeteve shpërthyes; të ndihmojë autoritetet civile përmes operacioneve të mbrojtjes civile. Forca e Sigurisë së Kosovës përbëhet nga Komanda e Forcave Tokësore, Brigada e Reagimit të Shpejtë, Brigada e Mbështetjes së Operacioneve dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes. Forca e Sigurisë së Kosovës përbëhet nga personeli profesional i sigurisë, personeli rezervë, personeli civil dhe rekrutet.

Detyrat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të FSK-së

- Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës janë të autorizuar të shërbejnë brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe dërgohen jashtë vendit në operacione vetëm kur t'u jepet mandati nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- Secili anëtarë i FSK-së është i obliguar që të kryej të gjitha detyrat që i caktohen në mënyrë të përgjegjshme, me nder, me paanshmëri dhe në përputhje me ligjet në fuqi në Kosovë dhe me të gjitha rregulloret e FSK-së;
- Të shërbejë me besnikëri në FSK dhe në institucionet tjera të Qeverisë së Kosovës pavarësisht nga pikëpamjet ose orientimet politike;
- Të zbatojë të gjitha urdhrat e ligjshme të eprorëve;
- Të mbajë uniformën dhe emblemat e FSK-së në përputhje me rregulloret përkatëse;
- Të veprojë me integritet gjatë gjithë kohës dhe të mos e keqpërdorë pozitën e tij/saj zyrtare ose informatat zyrtare për përfitim të tij/saj personal ose të tjerëve.
- Pjesëtarët e FSK-së duhet t'i kryejnë në mënyrë profesionale detyrat e dhëna sipas mandatit dhe ato shtesë brenda periudhës së pranueshme kohore.

- Të mbrojnë të gjitha informatat, në çfarëdo forme, si dhe pajisjet e marra ose që u janë dhënë gjatë detyrës në përputhje me rregullat e parashtruara në ligjet dhe rregulloret që rregullojnë sigurinë e informatave dhe të pajisjeve;
- Të përmbahen nga dhënia e deklaratave publike përmes shtypit ose forumeve të tjera që kanë të bëjnë me FSK-në, pjesëtarët ose aktivitetet e saj pa e marrë paraprakisht pëlqimin përmes zinxhirit komandues;
- Në detyrë dhe jashtë saj, të trajtojnë pjesëtarët e FSK-së dhe të gjithë të tjerët në përputhje me ligjin, pa diskriminim ose ngacmim në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në bazë të racës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose mendimit tjetër, origjinës kombëtare ose sociale, lidhjes me ndonjë komunitet, pasurisë, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar të lindur ose ndonjë statusi tjetër;
- Të shmangin çfarëdo aktiviteti që mund të përbëjë konflikt faktik ose të dukshëm të interesit ndërmjet detyrave profesionale dhe interesave private, politike ose financiare;
- Dështimi për t'iu përmbajtur këtyre obligimeve mund të trajtohet në përputhje me dispozitat e Kodit Disiplinor dhe ligjet tjera në fuqi.

Kushtet për aplikim;

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të ketë të përfunduar shkollën e mesme,
- Të jetë i moshës 18-25 vjeç.

Përzgjedhja;

- Shqyrtimi fillestar i aplikacioneve,
- Testi i aftësive,
- Testi fizik,
- Intervista me shkrim dhe me gojë,
- Testin mjekësor,
- Trajnimi,
- Verifikimi.
- Emërimi.
- E drejta e ankesës.

Dokumentet për regjistrim;

- Dëshmi, certifikata, mirënjohje (nëse posedon),
- Diploma (dëshmi) e shkollimeve të përfunduara,
- Certifikatën e lindjes (jo me të vjetër se 6 muaj),
- Certifikatën e shtetësisë,
- Kopje të letërnjoftimit apo pasaportës,
- Dy fotografi të formatit (5 cm x 5 cm).

Si të aplikoni;

Formularët për aplikim janë në dispozicion në të gjitha kazermet e FSK-së, apo në web-faqen e M-FSK-së, www.mksf-rks.org, apo www.rks-gov.net/mfsk ku gjendet shpallja e konkursit. Formularët duhet të dorëzohen personalisht, në të gjitha kazermet e FSK-së, në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Kandidatët duhet t'ia bashkëngjisin aplikacionit kopjet e dokumenteve që dëshmojnë përmbushjen e kushteve të nevojshme. Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr.tel. 038-603-199, 038-603-355. Konkursi është i hapur prej 29.09-24.10.2014.

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës iu shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikacione të femrave dhe meshkujve për shërbim në FSK-së, pa dallim nga përkatësia e tyre etnike.